



Pranimar / Procesi / No. / Proc. No.			
18.01.2022 vit / god / year			
Organ / Organizata / Org. / Unit	Dr. / Prof. / Prof. No.	Shtojca / Funcig / Appendix	Sasia / Kopjime / Quantity
SKIMS/HC	203/2022		113



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.952/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca–anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.952/2021 të datës 22.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër organit të punësimit Këshilli për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.952/2021 e datës 22.11.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore në pozitën “zyrtar i lartë i personelit sipas akt emërimit AE.Nr.01/2021 të datës 11.03.2021, ka parashtruar ankesë me datën 21.11.2021 me numër protokollit 5576/2021 me arsyetimin se Zëvendësuesi i Udhëheqësit Ekzekutiv po e pengon në kryerjen e punëve sipas akt emërimit dhe përshkrimit të detyrave të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.11.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Me datën 06.12.2021 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës dhe është protokolluar me numër 5820/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.11.2021 me numër protokollit 5576/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi VK.nr.68/2021 të datës 29.12.2021 për shtyrje të afatit; Akt emërimit AE.Nr.01/2021 të datës 11.03.2021; Kërkesë e datës 30/08/2021; Akt emërimi i datës 02.10.2019; Kopja e konkursit e datës 11.02.2021; E-mail zyrtar i datës 15.10.2021; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë i personelit; E-mail zyrtar i datës 21.10.2021; E-mail zyrtar i datës 04.11.2021; E-mail zyrtar i datës 04.11.2021; E-mail Zyrtar i datës 21.10.2021(4,3,2,1); E-mail zyrtar i datës 04.10.2021; E-mail zyrtar i datës 05.10.2021, E-mail zyrtar i datës 06.10.2021; E-mail zyrtar i datës 07.10.2021; E-mail zyrtar i datës 21.10.2021; E-mail zyrtar i datës 09.11.2021; E-mail zyrtar i datës



10.11.2021; E-mail zyrtar i datës 10.11.2021; E-mail zyrtar i datës 10.11.2021; E-mail zyrtar i datës 11.11.2021; E-mail zyrtar i datës 11.11.2021; E-mail zyrtar i datës 22.11.2021; E-mail zyrtar i datës 09.09.2021; E-mail zyrtar i datës 09.09.2021; E-mail zyrtar i datës 09.09.2021; E-mail zyrtar i datës 10.09.2021; E-mail zyrtar i datës 13.09.2021; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 01.09.2015; Dokumente shtesë të datës 17.12.2021 me nr. protokolli 6210; 21 emaila të shkëmbyer ; Vendimi i datës 07.09.2021 për ushtrimin e detyrës së sinjalizuesit; Vendimi i datës 14.10.2019 për ushtrimin e detyrës së Zyrtarit Certifikues Aprovues; Vendim i datës 04.03.2020 për zyrtar të arkivit; Akt emërimi i datës 11.03.2021; Pasqyra e pushimit mjekësor prej datës 30.11.2021 deri 10.12.2021; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 06.12.2021 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/15; Raporti i auditimit i vitit 2020 me vërejtje parregullsi në avancimin e stafit; E-mail zyrtar i datës 04.10.2021; E-mail zyrtar i datës 01.10.2021; E-mail zyrtar i datës 21.10.2021; përshkrimi i detyrave të punës asistent ekzekutiv; Prova shtesë nga ankuesi të datës 11.01.2022 me nr.protokolli 55/2022; Akt emërimi i datës 01.09.2021; Konfirmimi për përfundimin e konkurrimit i datës 30.08.2021; Formular i të dhënave për listën e pagave e datës 02.09.2021; Akt emërimi i datës 07.04.2021; Akt emërimi i datës 09.09.2021; Vendimi i datës 09.09.2021 me nr.14/21 për emërimin e nëpunësit civil në pozitën e kategorisë së mesme të drejtuese; Vendimi A.nr.902/2021 i datës 17.12.2021 me numër protokolli 6221/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 06.01.2022 dhe E-mail zyrtar i datës 31.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke marr parasysh pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Zëvendësuesi i Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit për Trashëgimi Kulturore e pengon në kryerjen e detyrave të punës sipas akt emërimit AE.Nr.01/2021 të datës 11.03.2021 në pozitën Zyrtar i lartë i Personelit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar që me rastin e parashtrimit të ankesës të datës 22.11.2021 me numër protokolli 5576/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka pas asnjë akt administrativ që ankuesit i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e tij e punës ashtu siq parashihet në nenin 125 paragrafi 1 i Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, **”1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”)**, kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar edhe në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 nenin 24 paragrafi 3, për Zyrtarët Publikë në të cilin paragraf përcaktohet se: **’3.Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji..’**konstaton se ankesa është e palejuar .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda, A.nr.952/2021, datë 18.01.2022

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesi
- Zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë;
- Njesisë të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.